



Datë: 04.09.2025
Numër Protokolli: 5983/2025

A.nr.1230/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxnikaj-Demi-anëtarë, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1230/2025, të datës 26.06.2025, të parashtruar nga ankuesja M.G-O, kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1230/2025, e datës 26.06.2025 e parashtruar nga ankuesja, M.G-O.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi me nr.84/2025 i datës 30.05.2025 për kandidatin fitues nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në konkursin e shpallur me nr.reference RN00016876, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Planifikim, klasa e pozitës Drejtues i Ulët.

A r s y e t i m

Ankuesja, M.G-O (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 26.06.2025. ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.1230/2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016876, për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Bugjet dhe Planifikim*, të shpallur më datë 27.02.2025 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 22.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MASHT, ndërsa kjo e fundit, me datë 12.08.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4384/2025, të datës 26.06.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e parashtrimit të ankesës të datës 26.06.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 22.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.08.2025, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura nga organi i punësimit; Konkursin me numër reference RN00016876, të datës 27.02.2025; Vendim për vazhdimin e afatit të procedurave të rekrutimit, me numër Nr.36/2025, i datës 14.04.2025; Lista e aplikantëve (*aprovuar dhe refuzuar*); Vendim për vazhdimin e afatit për përfundimin e procedurës së testit me shkrim, me numër Nr.73/2025, i datës 08.05.2025; Njoftimi për test me shkrim i datës 12.05.2025; Njoftimi për rezultatet e testit me shkrim, i datës 26.05.2025; Kopjen e letërnjoftimit; Formulari i përshkrimit të punës; Vendim për vazhdim afati të verifikimit me numër Nr.36/2025, të datës 14.04.2025; Vendim për themelimin e komisionit me numër Nr.2/1723, të datës 02.05.2025; Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës me numër protokolli Nr.2/1234, i datës 01.04.2025; Akt emërimi me numër Nr.86/2024, i datës 06.09.2024; Akt emërimi me numër 55/2024, i datës 05.09.2024; Akt emërimi me numër Nr.48/2024, i datës 05.09.2024; Akt emërimi me numër Nr.52/2024, i datës 05.09.2024; Kërkesë e datës 26.02.2025; Ftesë për intervistë me gojë, e datës 26.05.2025; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë, të datës 28.05.2025; Formularët e vlerësimit të përgjithshëm, të datës 26.05.2025; Pyetjet e hapura për testin individual; Njoftimi për kandidatin fitues me numër Nr.84/2025, i datës 30.05.2025; Aplikacionet me datë aplikimi 27.03.2025, të kandidatës A.B me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 25.03.2025, të kandidatit M.K, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 28.03.2025, të kandidatës M.G-O, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 04.03.2025, të kandidatit R.H, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 25.03.2025, të kandidatit A.D, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 03.03.2025, të kandidatës V.GJ, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Aplikacionet me datë aplikimi 28.03.2025, të kandidatës V.T-U, me të gjitha dokumentet e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është pranuar dhe është lëshuar në shqyrtim meritore dhe ka gjetur se ankesa është e pa **bazuar**, sepse:

Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me datë 27.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016876, për kategorinë Drejtues i Ulët, gjegjësisht për pozitën “*Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Planifikim*”, i cili ka qenë i hapur për aplikim nga data 28.02.2025 deri më datë 29.03.2025. Konkursi është shpallur në përputhje me Rregulloren Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, Kolegji është kujdesur edhe sa i përket përbërjes së Komisionit të Pranimi dhe ka konstatuar se Komisioni ka qenë në përputhje me dispozitat ligjore të parapara dhe gjithashtu ka shqyrtuar edhe anëtarin e Komisionit që ka qenë Ud, por periudha e Ud ka qenë në kuadër të nenit 35 të LZP.

Rrjedhimisht në këtë konkurs kanë aplikuar 7 kandidatë dhe sipas verifikimit paraprak, prej tyre 4 kandidatë kanë plotësuar kushtet formale për tu përfshirë në listën e ngushtë prej tyre edhe ankuesja, e cila ka marrë pjesë në testin me shkrim duke arritur gjithsejtë 49 pikë, të pa mjaftueshme për të vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë.

Njësia e Burimeve Njerëzore pranë organit përkatës të punësimit, më datë 30.05.2025, ka publikuar Njoftimin për renditjen përfundimtare sipas Konkursit me numër reference RN00016876, nga i cili rezulton se kandidatja A.B, me gjithsejtë 91,62 pikë të arritura është shpallur kandidatë fituese për pozitën *Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Planifikim*.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshill, pretendon për mungesë të transparencës në testin me shkrim, ngase sipas saj është krijuar pabarazi në trajtim dhe shkelje të parimit të konkurrencës së drejtë, duke theksuar ndër të tjera pretendimet sikur se janë shënuar në hyrje të këtij arsytimi. Kolegji ka shqyrtuar pretendimet e ankuese, por të gjitha janë të pa mbështetura në fakte dhe argumente ligjore, mos pjesëmarrja e komisionit komplet gjatë testimit me shkrim nuk e dëmton procesin, sepse testimi bëhet në mënyrë elektronike dhe është i barabartë për të gjithë, gjithashtu pretendimi se nuk janë përfshi dy pika të përshkrimit të punës lidhur me këtë pozitë nga rregullorja për organizim të brendshëm nuk ka vërë kandidatë pjesëmarrjen në pozita të pa barabarta apo të vërehet ndonjë lloj diskriminimi për të cilin Kolegji do të kujdese sipas obligimit ligjor.

Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të procedurës përkatëse të rekrutimit, duke u mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00016876, për pozitën *“Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Planifikim”*, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Drejtimi Ekonimik, financa apo kontabilitet*
- **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku tri(3) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për mungesë transparencë në testin me shkrim, mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimin Në Shërbimin Civil ku përcaktohet: *“Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publike që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimin në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”* si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullores (QRK) 15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimin, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimin.”* dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlejné njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, ndërsa vlerësimi i eses është në kompetencë të Komisionit të Pranimin, si rrjedhojë

pretendimi ankueses se testi me shkrim nuk është bazuar në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët nuk është i qëndrueshëm.

Tutje, duke u bazuar në nenin 89 të Ligjit Nr.05/L-031 ku përcaktohet se *“Vlerësimi i provave Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ; dhe kërkesave e përgjithshme formale të lartë theksuara, Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë ka shqyrtuar edhe dosjen e kandidatës që është shpallur fituese dhe ka konstatuar se posedon:*

Diplomën e datës 28.03.2025 me Nr.1990 , të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik në Universitetin e Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet me datë 29.05.2008 dhe mori titullin në Banka, Financa, Kontabilitet-Bsc, gjithashtu e njëjta ka Diplomën Nr. 1982 me të cilën dëshmohet se me datë 16.05.2019 mori titullin në Banka, Financa, Kontabilitet-Msc, sipas vërtetimit të datës 21.03.2025 ref 4/4-22 të lëshuar nga MASHT me përvojë pune nga data 21.06.2010; nga 27.11.2018 Zyrtare e lartë për Zotim; 03.12.2020 Zv.Kordinatorë e të hyrave dhe donacioneve; 01.10.2024 Ud e Divzionit për Buxhet dhe Planifikim dhe vazhdon tutje, prandaj kandidatja fituese ka plotësuar kushtet formale sipas konkursit të lartshënuar.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit me qëllim të kthimit të ligjshmërisë vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, dhe anulimin e procedurës së rekrutimit, sikurse është përcaktuar në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1230/2025

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.G-O;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.